



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesues i KD-së

Prof. dr. Ismet Salihu

Nr. Prot.: 3/572

Datë: 29.11.2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina" pasi shqyrtoi kërkesën me nr. prot: 3/955 dt: 20.11.2017 të parashtruar nga prof. asoc. dr. Bujar Dugolli, dekanë në Fakultetin Filozofik, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për udhëtim zyrtar në Shqipëri. Në mbledhjen e mbajtur më datë 23.11.2017 mori:

V E N D I M

- I. Prof. asoc. dr. Bujar Dugollit, dekan në Fakultetin Filozofik, së bashku me Prof. ass. dr. Dashamir Bexulli, prodekan për çështje mësimor në Fakultetin Filozofik dhe prof. dr. Adem Rusinofci, mësimdhënë në Fakultetin Arteve dhe kurator i ekspozitës, me ftesë të Muzeut Historik Kombëtar të Tiranës i'u lejohej pjesëmarrja në ekspozitën me titull: "1 Tetori përmes fotografive të kohës" që mbahet në Tiranë.
- II. Të përmendurit si në pikën I të këtij vendimi vizitën e realizojnë me qëllim që të jenë pjesëmarrës në cilësinë e përfaqësimit të Fakultetit Filozofik në ekspozitën me titull: "1 Tetori përmes fotografive të kohës" që ju kushtohet protestave të vitit 1997 dhe lëvizjes studentore e cila hapet me datë 26 nëntor 2017, në ambientet e Muzeun Historik Kombëtar të Tiranës, në vazhden e aktiviteteve të festës së nëntorit.
- III. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për realizimin e kësaj vizite të përmendurve si në pikën I të këtij vendimi do të mbuloj shpenzimet e karburantit në vlerë 100.00 euro, si dhe për dy ditët mëditjet konform Rregullores për udhëtime zyrtare jashtë vendit, të parapara nga fondi i buxheti të planifikuar për vitin 2017. Ndërsa për staf të angazhuar në bazë të Rregullores nuk mund të mbulohen shpenzime nga UP-ja.
- IV. Të përmendurit udhëtimin do të realizohet si në vijim: Nisja nga Prishtina më data 25 nëntor 2017, ndërsa kthimi nga Shqipëria me datë 26 nëntor 2017.
- V. Obligohet shërbimi financiar i UP-së, që të zbatoj këtë vendim, ndërsa pjesëmarrësit e kësaj vizite janë të obliguar që të gjitha shpenzimet, t'i arsyetojnë me fatura origjinale pran shërbimit financiar të Universitetit të Prishtinës.
- VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë kërkesa nr. Prot. 3/955 dt: 20.11.2017

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UP-së, pasi e shqyrtoi kërkesën e me Nr. prot: 03/955 dt: 20.11.2017 të parashtruar nga prof. asoc. dr. Bujar Dugolli, dekanë në Fakultetin Filozofik, për mbulimin e shpenzimeve për udhëtim zyrtar në Shqipëri me qëllim të pjesëmarrjes në ekspozitën me titull: "1 Tetori përmes fotografive të kohës" në cilësinë e këshillit organizativ të aktiviteteve për shënimin e 20 -të vjetorit që ju kushtohet protestave të vitit 1997 dhe lëvizjes studentore e cila hapet me datë 26 nëntor 2017, në ambientet e Muzeun Historik Kombëtar të Tiranës, në vazhden e aktiviteteve të festës së nëntorit. Mirëpo, për shkak të limiteve buxhetore me të cilat është duke u përballur UP-ja, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Parashtruesit të Kërkesës;
3. Shërbimit financiar të UP-së;
4. Arkëtares së UP-së
5. Zyrtarit Ligjor të KD-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Prof. dr. Ismet Salihu – Kryesues